

PERIODIKU BANKAR

VËSHTRIM MBI SEKTORIN
FINANCIAR TË KOSOVËS

PASQYRA E TË
ARDHURAVE TË
INDUSTRIË BANKARE

PERIODIKU BANKAR



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION



PËRGATITUR NGA:

DR. SC. PETRIT BALIJA,
Kryeredaktor

KRESHNIK KOSUMI,
Redaktor

MIRANDA RUGOVAJ
Koordinatore

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

DATA E PUBLIKIMIT,
Maj 2016



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Deklarata e autorësisë: Materiali në këtë publikim ka të drejta autoriale. Kopjimi apo përdorimi i një pjese apo i tërë publikimit pa leje apo pa shënuar burimin e informacionit mund të konsiderohet shkelje e ligjeve në fuqi.

PASQYRA E TË ARDHURAVE TË INDUSTRIISË BANKARE

PËRMBAJTJA

PJESA I

Pasqyra e të ardhurave të industrisë bankare 1-1

Të hyrat nga interesi, jointeresi dhe nga rivlerësimi 1-2

Niveli i kredive jo-performuese në Kosovë dhe provizionimi i tyre 2-3

Shpenzimet e interesit, jointeresit, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative dhe provizioni për taksat 3-4

Raporti ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve 4-6

PJESA II

Indikatorët kryesorë të industrisë bankare 6-6

Struktura e aseteve 6-7

Struktura e detyrimeve 7-9

Norma efektive e interesit në kredi dhe depozita 9-10

Niveli i kredive jo-performuese 10-11

PJESA III

Lajme nga industria bankare 13- 16

I. PASQYRA E TË ARDHURAVE TË INDUSTRIISË BANKARE

Kosova si një ekonomi e re e krijuar nga viti 1999 ka shënuar në vazhdimësi rritje të numrave në kuadër të sistemit financiar. Në këtë rrafsh edhe industria bankare vazhdimisht është rritur, me ç'rast në muajin mars të vitit 2016 ka arritur vlerën e asetëve në 3,397.8 miliardë euro. Në këtë kuptim, industria bankare shënoj rritje si në vlerën e gjithsej asetëve, po ashtu shënoj rritje në vlerën e depozitave, kredive, transaksioneve, performancës ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve, duke ofruar kështu siguri, stabilitet dhe qëndrueshmëri, faktorë të cilët janë shumë të rëndësishëm në ngritjen e besueshmërisë të klientëve/ qytetarëve të Republikës së Kosovës ndaj industrisë bankare.



Përveç rritjes në vlerë të asetëve, industria bankare ka shënuar rritje të të hyrave sidomos gjatë vitit të kaluar, çka tregon se industria bankare është e shëndoshë dhe ofron qëndrueshmëri dhe siguri në depozitat që qytetarët e Republikës së Kosovës i mbajnë tek industria bankare.

Të hyrat nga interesi, jointerеси dhe nga rivlerësimi

Industria bankare në Kosovë gjithashtu ka shënuar vazhdimisht vlera pozitive të të hyrave në raport me shpenzimet. Është e rëndësishme të vlerësohet fakti se industria bankare në pesë vitet e fundit të operimit, ka shënuar vlera shumë të përiferita të të hyrave, përderisa ka shënuar rritje të profitit neto. E gjithë kjo është arritur si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të industrisë bankare. Në fund të vitit 2015, 75.7% të gjithsej të hyrave e përbënin të hyrat nga interesi i përfituar nga kreditë e lëshuara, përderisa pjesën tjetër të të hyrave e përbëjnë të hyrat nga interesi për letrat me vlerë, plasmanet tjera si dhe të hyrat nga jo-interesi.

Në vijim të tabelës 1 mund të shihet se kemi një rënie të lehtë të të hyrave nga interesi për kredi, përderisa rritje të lehtë nga të hyrat e interesit për letrat me vlerë si dhe nga të hyrat nga tarifatat dhe komisionet (kjo e fundit kryesisht si rezultat i rritjes së numrit të transaksioneve). Në tabelën 1 mund të shohim llojet e të hyrave si dhe gjithsej të hyrat e industrisë bankare.

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE
 (milion euro)

Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimi	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
2010	169.6	2.7	3.1	0.4	37.5	3.9	.	217.2
2011	186.3	4.1	4.2	0.5	41.7	3.3	.	240.1
2012	194.9	2.0	3.0	0.6	44.2	2.4	.	247.0
2013	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	1.2	249.0
2014	190.7	1.1	2.9	2.5	44.6	3.1	0.5	245.3
2015	180.4	0.5	4.4	0.7	47.1	4.0	1.1	238.2

Tab. 1 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (prill 2016)

Figura 1 paraqet nivelin e pjesëmarrjes së tri llojeve të të hyrave në raport me gjithsej të hyrat e industrisë bankare. Siç shihet edhe nga figura, pjesën kryesore të të hyrave e përbëjnë të hyrat nga interesi të cilat janë të qëndrueshme gjatë gjithë viteve të marra për bazë krahasimi, me një rënie të lehtë në fund të vitit 2015.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (prill 2016)

Shpenzimet e interesit, jointeresit, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative dhe provizioni për taksat

Raporti ndërmjet gjithsej të hyrave dhe shpenzimeve paraqet diferencën nëse industria bankare ka shënuar profit apo humbje gjatë operimit. Në këtë kuptim edhe menaxhimi i kujdesshëm i shpenzimeve nga industria bankare është shumë e rëndësishme. Tabela 2 tregon llojet e shpenzimeve në raport me gjithsej shpenzimet e industrisë bankare.

SHPENZIMET E INDUSTRIËS BANKARE (milion euro)										
Periodha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
2010	49.4	4.8	1.1	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	5.5	184.8
2011	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	5.3	204.1
2012	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	4.0	228.6
2013	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	3.2	223.0
2014	36.4	3.3	4.5	11.1	20.5	42.7	35.1	24.4	6.8	184.8
2015	16.7	3.8	2.1	12.0	-8.4	44.0	35.7	27.8	9.7	143.5

Tab. 2 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (mars 2016)

Sikurse shihet nga tabela, gjithsej shpenzimet e industrisë bankare në fund të vitit 2015 kanë shënuar rënie për 22.3% në raport me vitin 2014, përderisa 17.1% ishte zvogëlimi i shpenzimeve në fund të vitit 2014 në raport me vitin 2013.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë shpenzimet e personelit të cilat në fund të vitit 2015 paraqesin 30.6% të gjithsej shpenzimeve. Pas kësaj me 24.8% e përbëjnë shpenzimet e përgjithshme, përderisa shpenzimet tjera nga jo-interesi përbëjnë 19.3% në raport me gjithsej shpenzimet.




Fig. 2 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (prill 2016)

Figura 2 paraqet pjesëmarrjen e llojeve të shpenzimeve në raport me gjithsej shpenzimet e industrisë bankare. Nga kjo figurë mund të shihet se në dy vitet e fundit kemi një rritje të shpenzimeve të përgjithshme administrative në raport me llojet e tjera të shpenzimeve, si dhe zvogëlim të shpenzimeve të interesit dhe të jo-interesit.

Raporti ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve

Në figurën 3 janë të paraqitura trendet e të hyrave dhe shpenzimeve si dhe ndryshimin ndërmjet këtyre dy indikatorëve, përkatësisht fitimin e realizuar nga industria bankare.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (prill 2016)

Industria bankare në fund të vitit 2015 shënoj një fitim në vlerë prej 94.7 milionë euro, që paraqet një rritje prej 56.5% më shumë se sa në vitin 2014. Sikurse mund të shihet edhe nga grafikoni, trendi i rritjes së fitimit neto në tri vitet e fundit korespondon me trendin e zvogëlimit të shpenzimeve, përderisa gjithsej të hyrat qëndrojnë afërsisht në një linjë lineare nëpër vite.

Trendi i ngjashëm pozitiv duke shënuar fitim ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016, me ç'rast në tremujorin e parë janë shënuar gjithsej 57.6 milionë euro të hyra, përderisa shpenzime gjithsej 40.8 milionë euro, që në fakt paraqet një fitim neto prej 16.8 milionë euro.

Figura 4 paraqet të hyrat dhe shpenzimet e industrisë bankare vetëm për tremujorin e parë të vitit 2016 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2015.




Fig. 4 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

Siç shihet tremujori i parë i vitit 2016 ka shënuar një ulje të lehtë të të hyrave, shpenzimeve, por edhe të fitimit, nëse krahasohet me të njëjtën periudhë të vitit 2015. Sidoqoftë kjo figurë paraqet të dhënat e vetëm një tremujori dhe duhet të merren për bazë edhe të hyrat dhe shpenzimet e muajve tjerë gjatë vitit 2016 për të arritur në përfundimin nëse ky trend do të vazhdoj.

II. INDIKATORËT KRYESORË TË INDUSTRIËS BANKARE

Industria bankare në Kosovë ka treguar stabilitet dhe qëndrueshmëri në vazhdimësi që nga paslufta dhe deri në vitet e fundit, duke ofruar siguri si dhe duke treguar besueshmëri tek qytetarët e Republikës së Kosovës. Industria bankare ka shënuar vlera pozitive të rritjes pothuajse në të gjithë indikatorët kryesorë të saj, çka tregon për një treg të shëndoshë të kësaj industrie.

Struktura e asetëve

Tabela 3 tregon të dhëna mbi gjithsej asetet e industrisë bankare si dhe të strukturës së kësaj industrie.

STRUKTURA E ASETËVE TË INDUSTRIËS BANKARE (milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Mar-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	447.1	491.2	447.4
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	390.7	316.0	318.4
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8	473.5	467.9
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4	2,019.4	2,070.2
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7	57.3	56.9
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	27.9	29.8	37.0
Gjithsej Asete	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,185.6	3,387.3	3,397.8

Tab. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (prill 2016)

Në kuadër të gjithsej asetëve të industrisë bankare, pjesën kryesore e përbëjnë kreditë dhe lizingu me gjithsej 60.9%, pastaj letrat me vlerë 13.7%, paraja e gatshme me 13.1% dhe kështu me radhë (mars 2016).




Fig. 5 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (prill 2016)

Trendi i rritjes të gjithsej asetëve dhe kredive mund të vërehet edhe nga figura 5 e paraqitur. Në fund të vitit 2015, gjithsej asetet janë rritur për 6.3% në raport me vitin 2014, përderisa kreditë dhe lizingu është rritur për 7.2% gjatë të njëjtës periudhë. Të dhënat e paraqitura për tremujorin e parë të vitit 2016 nuk mund të krahasohen me periudhat paraprake, meqenëse nuk paraqesin vitin e plotë, mirëpo janë pasqyruar vetëm për qëllime informacioni, megjithëse edhe në këtë rast mund të vërehet se trendi i ngjashëm i rritjes vazhdon edhe gjatë vitit 2016.

Struktura e detyrimeve

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRISË BANKARE (2010 - 2016) (milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Mar-16
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	31.6	43.4	59.4
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,701.4	2,664.0
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1	17.6	17.7
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9	3.1	2.8
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.2	191.2	205.9
Borxhi i ndërvarur	33.5	31.0	31.0	56.3	47.3	36.8	37.8
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-	-	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.0	393.8	410.0
Gjithsej Detyrime	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,185.6	3,387.3	3,397.8

Tab. 4 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (prill 2016)

Në kuadër të strukturës së detyrimeve nga tabela 4 mund të shihet se depozitat dominojnë pjesën kryesore me gjithsej 78.4% të gjithsej detyrimeve në mars të vitit 2016, përderisa pjesën tjetër e përbëjnë mjetet vetanake me 12.0%, detyrimet tjera me 6.0% dhe kështu me radhë.

Tabela 5 tregon mbi raportin ndërmjet depozitave dhe kredive të industrisë bankare. Nga të dhënat e marra për bazë krahasimi, mund të shihet se industria bankare vazhdimisht ka synuar të mbaj raportin ndërmjet kredive dhe depozitave nën normën prej 80%, duke qenë kështu likuide gjatë gjithë kohës dhe e gatshme të mbuloj obligimet e saj në çdo kohë.

KREDITË BRUTO NË RAPORT ME DEPOZITAT (2010 - 2016) (milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Mar-16
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,701.4	2,664.0
Kreditë bruto dhe lizingjet	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4	2,019.4	2,070.2
Raporti	75.3%	80.7%	77.4%	73.7%	74.2%	74.8%	77.7%

Tab. 5 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (prill 2016)

Në figurën 6 gjithashtu mund të vërehet trendi rritës i të dy indikatorëve më kryesorë të industrisë bankare që janë depozitat dhe kreditë. Të dhënat e paraqitura për tremujorin e parë të vitit 2016 nuk mund të krahasohen me periudha paraprake, meqenëse nuk paraqesin vitin e plotë, mirëpo janë pasqyruar vetëm për qëllime informacioni.




Fig. 6 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (prill 2016)

Rritja e depozitave dhe kredive është në raport afërsisht të ngjashëm me njëra tjetrën, duke siguruar që kreditë e lëshuara nga kjo industri të mos tejkalojnë asnjëherë depozitat e qytetarëve që i kanë deponuar.

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010 - 2016)											
(milion euro)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	22.0	113.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	55.0	99.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	54.5	108.8	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	68.8	102.6	1,217.4
2014	49.8	19.7	153.0	20.3	107.0	674.5	51.4	18.1	60.6	102.0	1,256.4
2015	59.9	19.2	164.1	17.8	99.5	683.0	50.7	21.3	94.0	123.8	1,333.4
Mar-16	54.3	18.7	171.6	18.9	99.0	701.9	47.4	20.7	95.6	124.1	1,352.3

Tab. 6 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik (mars 2016)

Në kuadër të strukturës së kredive të lëshuara për sektorë të ekonomisë, dominojnë kreditë e lëshuara për tregti të cilat në tremujorin e parë të vitit 2016 përbënin 51.9% të gjithsej kredive sipas aktivitetit ekonomik, pastaj prodhimi me 12.7%, shërbimet tjera me 9.2% dhe kështu me radhë. Në tremujorin e parë të vitit 2016 vërehet se trendi i ngjashëm i rritjes së kreditimit vazhdon edhe gjatë vitit 2016.

Normat efektive të interesit në kredi dhe depozita

Industria bankare gjatë dy viteve të fundit ka arritur që të zvogëloj ndjeshëm normën efektive të interesit në kredi, çka nënkupton se kostoja e kredisë për qytetarët e Kosovës është zvogëluar. Me uljen e normës efektive të interesit në kredi, pavarësisht rënies së normës efektive të interesit në depozita, ka bërë që të zvogëlohet edhe diferenca në përqindje ndërmjet këtyre dy normave.




Fig. 7 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në kredi dhe depozita të reja (prill 2016)

Siç shihet edhe nga trendi i paraqitur në figurën 7, që nga viti 2012 të dy normat e interesit, duke përfshirë edhe margjinën ndërmjet normës së interesit në kredi dhe depozita kanë shënuar ulje të ndjeshme.

Është e rëndësishme të potencohet se norma efektive e interesit në kredi ka arritur vlerën më të ultë që ka shënuar ndonjëherë industria bankare në Kosovë, që në fakt paraqet një sukses shumë të rëndësishëm për këtë industri si dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Niveli i kredive jo-performuese

Industria bankare në Kosovë edhe në aspekt të menaxhimit të cilësisë së portofolios kreditore ka qenë shumë e kujdesshme duke bërë kështu normat e këtyre kredive të jenë shumë të ulëta, çka ka bërë që besimi tek ky sektor të jetë edhe më i lartë.

Për të parë këtë zhvillim, figura 8 tregon përqindjen e kredive jo-performuese dhe përqindjen e rritjes/zvogëlimit të kredive jo-performuese në raport me përqindjen e rritjes së gjithsej portofolios kreditore.




Fig. 8 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (mars 2016), raporti vjetor 2014 dhe raporti i informatave mujore (dhjetor 2015)

Në fund të vitit 2015 përqindja e kredive jo-performuese shënoj vlerat prej 6.2%, çka paraqet një zvogëlim të kësaj përqindje prej 18.9% në raport me vitin 2014. Këtë zvogëlim e bën edhe më të rëndësishëm, përqindja e rritjes së portofolios kreditore prej 7.3%, që nënkupton se pavarësisht rritjes së portofolios kreditore, përqindja e kredive jo-performuese është zvogëluar. Nga viti 2012 dhe deri me 2015 përqindja e kredive jo-performuese ka shënuar ulje, siç mund të shihet edhe nga trendi i paraqitur në figurën 8.

KREDITË JO-PERFORMUESE (2010 - 2015)

(milion euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Vlerat e kredive jo-performuese	86.1	96.8	132.3	157.1	154.4	125.2
Provizionet për humbje nga kreditë	115.0%	116.7%	112.7%	110.5%	114.4%	115.1%

Tab. 7 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (mars 2016), raporti vjetor 2014 dhe raporti i informatave mujore (dhjetor 2015)

Në tabelën 7 është e paraqitur vlera në euro e kredive jo-peformuese në raport me përqindjen e provizionimit që industria bankare i ka ndarë për humbjet nga kreditë. Një nga masat parandaluese që bankat i ndërmarrin për t'u mbrojtur nga rreziku kreditor, përkatësisht nga kreditë jo-peformuese është provizionimi i kredive të lëshuara. Tabela 7, tregon se në fund të vitit 2015 bankat kanë ndarë provizione deri në 115.1% për të mbuluar humbjet e mundshme nga kreditë jo-peformuese. Kjo nënkupton se bankat janë në gjendje të mbulojnë shpenzimet që mund të vijnë nga humbjet si rezultat i kredive jo-peformuese.

Referencat

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, prill 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i informatave mujore të sistemit financiar, dhjetor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=98>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor 2013 dhe 2014, <http://bqk-kos.org/?id=102>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në depozita të reja, prill 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në kredi të reja, prill 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese, prill 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

PJESA III

LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN

MUAJIN MARS

JAVA NDËRKOMBËTARE E PARASË 2016 “MERR PJESË, KURSE NË MËNYRË TË MENÇURI!” (TAKE PART, SAVE SMART!)



Shoqata e Bankave të Kosovës, nga data 14 mars deri më datën 18 mars 2016 do të jetë nikoqir i aktiviteteve të ndryshme për të shënuar Javën Ndërkombëtare të Parasë. SHBK në kuadër të aktiviteteve të saja edukativo-financiare organizon ligjerata, orë mësimore dhe aktivitete të ndryshme për fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme dhe studentë në

disa qendra të Kosovës (Prishtinë, Gjilan, Pejë dhe Mitrovicë). Ky aktivitet është i organizuar në 124 vende të botës ndërsa koordinohet në nivel botëror nga Organizata Financiare për Fëmijë dhe të Rinjë (Child & Youth Finance International), organizatë jo-profitabile me seli në Amsterdam. Në Kosovë ky aktivitet vjen i organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës.

Aktivitetet përfshijnë punëtori me fëmijë, të rinjë dhe studentë në fushën e menaxhimit të parasë, kursimeve, menaxhimi i financave personale. Qëllimi kryesor i shënimit të kësaj jave është fuqizimi i gjeneratave të reja, që të marrin njohuri ekonomike-financiare nga ekspertë të sistemit bankar dhe rrjedhimisht të jenë të përgjegjshëm me financat e tyre.

Aktivitetet do të organizohen gjatë tërë javes në këto qendra:

- 14 mars 2016 –ligjeratë për kursimet me nxënësit e shkolles fillore “Model” në Prishtinë
- 15 mars 2016 –do të mbahet ligjeratë për kursimet me nxënësit e shkolles fillore “Selami Hallaçi” në Gjilan,
- 16 mars 2016 –do të mbahet punëtori rreth kursimeve, shpenzimeve, investimeve dhe menaxhimit të parasë me nxënësit e Shkolles së Mesme profesionale “Ali Hadri” në Pejë,
- 17 mars 2016 –ligjeratë për paranë dhe kursimet në shkollën International School of Prishtina (ISP)
- 18 mars 2016 –do të mbahet punëtori për kursimet, shpenzimet, investimet, dhe menaxhimi i financave personale me studentët e Kolegjit Ndërkombëtar në Mitrovicë (IBCM). (Agjencia e Lajmeve Ekonommia, Gazeta Monitor, Tribuna Channel, Bota Sot, 14 mars 2016; Kosova Sot, Bota Press, 15 mars 2016).

FONDI KOSOVAR PËR GARANTIMIN E KREDIVE DISKUTOHET NË SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS



Më 2 Mars 2016, Shoqata e Bankave të Kosovës është takuar me Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) për të diskutuar mbi mundësinë e kësaj agjencie për të mbështetur Fondin Kosovar të Garantimit të Kredive të themeluar me Ligjin përkatës dhe të miratuar në Kuvend disa muaj më parë. Me këtë rast Z. Petrit Balija, Drejtor Ekzekutiv i SHBK-së, i dha mbështetje të plotë themelimit të këtij Fondi i cili mbështetet edhe nga organizata tjera si USAID, Banka Gjermane për Zhvillim, Qeveria Zvicerane dhe Ministria Tregëtisë dhe Industrisë. Z. Balija tha se me ndihmën e bankave komerciale të Kosovës qëllimet e këtij fondi mund të jetësohen për ti dhënë mundësi më të mëdha bizneseve të Kosovës për qasje më të madhe në financa. Në anën tjetër Z. Stefan Jansson, këshilltarë përfaqësues i SIDA falenderoj Shoqatën e Bankave për mbështetjen e dhënë në këtë proces dhe u shpreh se SIDA është duke konsideruar mundësinë që të kontribuoj në këtë Fond për të mbështetur financimin e bizneseve të vogla dhe të mesme për të zhvilluar ekonominë e vendit. Z. Balija me këtë rast falenderoj qeverinë Suedeze dhe SIDA për mbështetjen e tyre të vazhdueshme për Kosovën. Në këtë takim ishte

prezent edhe z. Fatos Mulla, Zyrtar i Programit Ekonomik pranë Ambasadës Suedeze në Kosovë. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, Bota Sot, Bota Press, Kosovalive 360, 3 mars 2016).

PËRKRAHJA E BB-SË ESENCIALE PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS



Kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, ka pritur të hënën në takim zëvendës presidentin e Bankës Botërore për Evropë dhe Azi Qendrore, Cyril Muller. Gjatë takimit u bisedua për proceset zhvillimore ekonomike në Kosovë dhe për bashkëpunimin e përkrahjen e mëtejshme të Bankës Botërore për Kosovën. Kryeministri Mustafa e njoftoi për progresin në Kosovë, për rezultatet e reformave substanciale fiskale e strukturore që janë ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës, si dhe për avancimin e vazhdueshëm të ambientit biznesor e të aspekteve tjera që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social në Kosovë. Duke e falënderuar për mbështetjen e deritashme, kryeministri Mustafa kërkoi përkrahje të mëtejshme të Bankës Botërore për projektet zhvillimore ekonomike. Zëvendës presidenti i Bankës Botërore për Evropë dhe Azi Qendrore, Cyril Muller, vlerësoi progresin në Kosovë, duke shprehur përkrahjen e Bankës Botërore për Kosovën. (Zëri, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, Kosova Sot, 1 mars 2016).

3 MIJË VENDE TË REJA PUNE



Ministria e Bujqësisë, në programin për bujqësinë dhe zhvillimin rural të vitit 2016, përveç se ka rritur buxhetin për 3 milionë euro më shumë se vitin e kaluar, e ka zgjeruar edhe mbështetjen për shumë sektor të bujqësisë, si dhe ka krijuar disa ndryshime në program duke lehtësuar në shumë vende disa kritere për aplikim për fermerët. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Memli Krasniqi, tha se përmes këtyre programeve, për të cilat sivjet janë planifikuar 46 milionë euro, synojnë të mbështesin mbi 400 ferma dhe agrobiznese, si dhe hapjen e rreth 3 mijë vendeve të reja të punës, duke ndikuar kështu në zhvillimin dhe fuqizimin e sektorit në mbarë vendin. (Zëri, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 2 mars 2016).

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS MERR PJESË NË KONFERENCEN “FINANCIMI I KONTRATAVE DHE EFIÇENCA NË PAGESA NË TREGUN E KOSOVËS”



Drejtori ekzekutiv i SHBK-së, z. Petrit Balija mori pjesë në panelin e konferencës “Financimi i Kontratave

dhe Efiçenca në Pagesa në tregun e Kosovës” e organizuar me datën 31 Mars, 2016. Konferenca trajtoi temën e financimit të kontratave përmes faktoringut financiar si dhe efiçencën e pagesave në tregun e Kosovës.

Me këtë rast duke përmendur uljen drastike të normës së intersit për kredi si dhe përmirësimin e kushteve tjera të huamarrjes në Kosovë, z. Balija tha “Financimi përmes faktoringut është një temë mjaft e qëlluar për këtë tryezë pasi që nuk është trajtuar ende mjaftueshëm në Kosovë dhe paraqet një mundësi shtesë për finanimin e bizneseve të Kosovës e në veçanti bizneseve të cilat kanë nevojë sezonale për mbështetje financiare. Megjithatë, për të pasë sukses faktoringu financiar, ekzistojnë një numër reformash që duhet ndërmarrë në ambientin e të bërit biznes në Kosovë.”

Z. Balija listoi një sërë faktorësh të cilët duhet të përmirësohen siq janë: sigurimi i produkteve agrare nga agrobiznesi, përmirësimi i zbatimit të kontratave dhe rritja e numrit të përmbauesve privat, njohja më e mirë e kamatvonesës nga gjyqësori në Kosovë, si dhe rekomandoi që faktoringu në Kosovë duhet të fillojë në formën graduale ku mund të aplikohet Hipoteka Mix e cila, siç sqaroi ai, është një kombinim i kolateralizimit të kontratave duke përfshirë këtu edhe faktoringun.

Në panelin e kësaj konference mori pjesë edhe zv/drejtoresha e bankes ProCredit, znj. Eriola Biboli e cila përmendi disa nga përmirësimet e sistemit bankar që janë shënuar në vitet e fundit dhe poashtu elaboroi përvojat e Procredit Bank në lidhje me temën në fjalë.

Kjo konferencë u organizua nga Klubi i Prodhuësve të Kosovës ndërsa pjesëmarrës ishin akterët kyq nga USAID, KIESA dhe përfaqësues nga sektori bankar. (Rrokum TV, 31 mars 2016).

ASETET E SEKTORIT PENSIONAL, ARRIJNË NË 1.2 MILIARD EURO



Banka Qendrore e Kosovës (BQK), ka njoftuar, se vlera e aseteve e sektorit pensional në Kosovë, ka arritur në 1.24 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 13.1 për qind. “Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) përfaqëson pjesën më të madhe të aseteve të sektorit me 99.4 për qind, ndërsa pjesa e mbetur 0.6 për qind) menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP)”, është thënë në raportin e BQK-së për vlerësimin tremujor të ekonomisë. Sipas BQK-së, në dhjetor 2015, vlera e gjithsej aseteve të FKPK-së arriti në 1.23 miliardë euro, që përkon me rritje vjetore prej 13.1 për qind, rritje kjo më e ngadalshme krahasuar me rritjen vjetore prej 19.1 për qind të regjistruar në dhjetor 2014. (Zëri, Epoka e Re, Telegrafi, 9 mars 2016).

RRITET PËR 6 % EKSPORTI I PRODUKTEVE BUJQËSORE TË KOSOVËS



Eksporti i produkteve bujqësore të Kosovës shënoi rritje për 6 % në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014. Sipas të dhënave që Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore ka përgatitur bashkë me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, në vitin 2015 kishte 2 milionë e 300 mijë euro më shumë eksportim. Në vitin 2014 ishin mbi 39 milionë e 300 mijë euro eksporte, ndërkaj në vitin 2015 u realizuan mbi 41 milionë e 600 mijë euro. Rritja e përgjithshme është reflektuar edhe në sektorë të veçantë, qoftë tek pemët dhe perimet dhe produktet e përpunuara nga to. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 11 mars 2016).

BQE ZBRET NË 0 PËR QIND NORMEN E INTERESAVE NË EUROZONË




Banka Qendrore Evropiane shpalli të enjten uljen në 0 të interesave në Eurozonë, duke miratuar një tjetër paketë masash për të nxitur ekonominë e Eurozonës dhe luftuar rënien e çmimeve. Në mbledhjen e fundit, Këshilli Mbikëqyrës uli më tej në territor negativ, normën që kjo bankë paguan për depozitat e bankave private, nga minus 0.3 në minus 0.4 për qind. Paralelisht, Këshilli uli normën bazë të rifinancimit nga 0.05 në 0 për qind dhe zgjeroi programin e injektimit të parave në ekonomi. BQE pritet gjithashtu që të zgjerojë programin e saj lehtësues duke futur në treg jo më 60 por 80 miliardë euro në muaj. Skema tashmë do të përfshijë blerjen e bondeve të korporatave, si dhe borxhet e qeverive. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 11 mars 2016).

PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“Periodiku Bankar” është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë. Çdo publikim mujor trajton çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore ka sektorin bankar në Kosovë.
www.bankassoc-kos.com.





Qendra për Trajnime Bankare

TRAJNIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2016:

Certifikimi Ndërkombëtar EFCB

Bazat e Pajtueshmërisë

Lidershipi dhe formimi i Ekipeve

Menaxhimi i Riskut Operacional

Menaxhimi i Porfolios së Riskut Kreditor

IFRS

Nga Zyrtar i TI në Auditor të TI

Mbikëqyrja e Stafit

Mirësjellja në Biznes



Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

038 246 171

kbtraining@bankassoc-kos.com



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Design: Mithat Sejdiu